

NJOFTIM

PËR REKRUTIMIN E NJË EKSPERTI NË SEKSIONIN PËR MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Në kuadër të zbatimit të marrëveshjes me nr.338 Prot, datë 28.09.2020 të nënshkruar ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit dhe UNICEF-it, Institucioni i Avokatit të Popullit kërkon të rekrutojë një ekspert në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve (SMPDF), për një periudhë kohore **01.10.2020-30.09.2021.**

Objektivat dhe veprimtaria

Objektivat kanë të bëjnë me:

- 1.Organizimin e veprimtarive promovuese për mbrojtjen e fëmijës me strukturat përgjegjëse të mekanizmit të mbrojtjes së fëmijëve në nivel qendror dhe vendor;
- 2.Rritjen e kapaciteteve të zyrave rajonale dhe strukturave në nivel vendor, për monitorimin e mbrojtjes së fëmijës;
- 3.Kryerjen e inspektimeve në institucionet e privimit të lirisë në zbatim të legjislacionit të brendshëm dhe hartimi i raporteve me gjetjet përkatëse;
- 4.Organizimin e ditëve të hapura me fëmijët me qëllim rritjen e numrit të ankesave /kërkesave nga vetë fëmijët
- 5.Pregatitja e udhëzimit me praktikat më të mira të punës (raste suksesi) të SMPDF në Institucionin e Avokatit të Popullit me një gjuhë të thjeshtë dhe miqësore me fëmijët.

Këto objektiva do të arrihen përmes aktiviteteve të mëposhtme:

- a.Organizimin e ëbinareve online me fëmijët me qëllim rritjen e ankesave nga fëmijët në Institucionin e Avokatit të Popullit.
- b.Organizimin e takimeve online/ditëve të hapura me strukturat përgjegjëse shtetërore në nivel rajonal dhe vendor, që punonjnë për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës;
- c.Kryerja e inspektimeve në institucionet e privimit të lirisë, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga institucioni i Avokatit të Popullit, dhe shtrirja e inspektimeve edhe në qytete të tjera të vendit.
- d.Identifikimi i praktikave të mira të punës nga SMPDF gjatë trajtimit të ankesave/kërkesave dhe rasteve me iniciativë dhe përshtatja në një gjuhë të thjeshtë dhe miqësore.

Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve

Kandidatët që duan të aplikojnë për këtë pozicion, duhet të plotësojnë kriteret dhe procedurat e mëposhtme:

Të kenë mbaruar arsimin e lartë në profilin jurist ose punonjës social.

Të kenë përvojë profesionale në fushën e mbrojtjes të fëmijës dhe njohuri në drejtësinë penale, sidomos njohje të legjislacionit në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe administrimit të drejtësisë penale për të miturit;

Të kenë njohje të thellë të gjuhës angleze, në të folur dhe në të shkruar; aftësi komunikimi;

Të zotërojnë leje drejtimi automjeti dhe të jenë të gatshëm për të udhëtuar;

Të përmbushin afatet, të jenë të gatshëm për të punuar fort, edhe gjatë ditëve të pushimit javor, si dhe të orientuar drejt arritjes së rezultateve;

Të kenë fleksibilitet, aftësi të forta përshtatjeje në mjedis dhe aftësi për punë në ekip;

Të kenë njohuri të mira kompjuterike në programet Microsoft Word, Excel, si dhe njohuri të sistemeve të Teknologjisë së Informacionit (IT).

Përshkrimi i punës

Detyrat e ekspertit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve do të jenë:

Të kryejë inspektime pranë organeve të administratës publike qendrore apo vendore, si edhe në terren dhe vende ku ka sinjalizime/njoftime për shkelje të të drejtave dhe lirive të fëmijëve, pas marrjes së miratimit ose me urdhër të Komisionerit përkatës;

Të hartojë rekomandime për çështje të veçanta apo edhe rekomandime legjislative në rastet kur vetë ligji apo akti nënligjor përbën premisë për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të fëmijëve;

Të ndjekë dhe monitorojë zbatimin e rekomandimeve të paraqitura nga nga Avokati I Popullit pranë organeve të administratës publike në kuadër të zgjidhjes së rasteve konkrete dhe mbrojtjes sa më efektive të të drejtave dhe interesave të ligjshme të fëmijëve;

Të pregatisë informacione apo rekomandime për raportet periodike të monitorimit të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare;

Të marrë pjesë në grupet e hartimit të raporteve të veçanta dhe ndjekjen në vijim të rekomandimeve të dala gjatë hartimit të tyre.

Periudha dhe vendndodhja

Afati i rekrutimit do të përfshijë periudhën kohore Tetor 2020 - Shtator 2021.

Zyra e punës do të jetë në institucionin e Avokatit të Popullit, në adresën:

Bulevardi “Zhan’Dark”, nr.2, Tiranë.

Procedura e përgjithshme e aplikimit:

Aplikimi duhet të përmbajë:

Letër motivimi;

Curriculum Vitae (CV);

Kopje të diplomës;
Kopje të librezës së punës;
Dëshmi të gjuhës së huaj (nëse ka)
Vërtetim të gjendjes gjyqësore

Aplikimet duhet të dërgohen në rrugë elektronike në adresën:
dburgija@avokatipopullit.gov.al, ose në zarf të mbyllur duke specifikuar pozicionin në adresën:

Institucioni i Avokati të Popullit
Bulevardi “Zhan’Dark”, nr.2, Tiranë, Shqipëri
Në vëmendje të Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe pritjes së Qytetarëve

Afati

Aplikimet pranohen deri në datën 16.10.2020, ora 16:30.

Do të shqyrtohen vetëm ato aplikime që mbërrijnë brenda këtij afati.
Pas vlerësimit të dokumentave vetëm kandidatët e suksesshëm do të ftohen për intervistë.